



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1883/2020  
Data: 09.03.2020

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e dytë -II- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 18.02.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkyetar i Komunës), Edon Curri (Drejtor i Administratës), Ali Axhami (Përfaqësues për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Naser Laqi (Përfaqësues për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bajrush Laqi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Faruk Dermku (Përfaqësues i OSB-së). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2019.
3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2019.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimi) e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
6. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratim dhe realizimi të projektit kapital “Kanali i mbyllur për ujërat atmosferike “ Seqishtë.
7. Shqyrtimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
8. Informatë mbi raportin vjetor 2019 të NPL Pastrimi Sh.A.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- raportin jemi munduar me paraqitur në vija të trasha që e ka përshkruar komunën gjatë vitit 2019. Materialin e kemi dërguar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Teuta Shkreta** thekson:- kërkoj sqarim për trajnimin jashtë vendit që është mbajtur për nëntë persona.

**Ajete Berisha** thekson:- bëhet fjalë për nëntë vendime për kompensimin e pagesës për mëditjet jashtë vendit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kërkoj sqarim në faqe shtatë pika 14 dhe 23 rregullimi i parkingut te shkolla në Paldenicë 13,000.00 €. Kërkoj sqarim në faqe tetë te zyra e personelit te rekrutimet e brendshme dhe të jashtme që është zyrtari për tatim në pronë që është rekrutim i jashtëm. A ka raste që komuna i ka humbur rastet në gjykata për vitin 2019. Faqe 18 transporti i nxënësve Hani i Elezit –Pustenik cilën pjesë e përfshin. Furnizim me dru nga kompania “Ahu”. Shtimi i kapacitetit të ujit a bëhet fjalë për shtim të kapaciteteve apo është investuar dhe nëse është shtuar duhet të dihet sa është shtuar kapacitetit i ujit. Faqe 20 vlerat nënjë mijë euro për publikimet te TV Dielli. Rregullimi i bravës së veturës Hiunday në shumë prej 260.00 €. Zyra për transparencë nuk e ka shënuar raportin për fshirjes e komenteve. Faqe 27 nuk janë paraqitur sa kërkesa janë të pranuar , kurse të miratuara janë të shënuara. Faqe 66 shpenzimet e autoambulancave dikund është me 14 litra, dikund është 13 litra dhe dikund është me 11 litra te makinat e ndryshme. Rastet me CA është mirë me bërë një lloj statistike sepse shihet që është në rritje numri dhe më shumë vërehen që janë në rritje te mushkрит dhe lenë me nënkuptuar që janë për shkak ndotjes së ambientit. Faqe 74 intervenim në zhbllokimin e kanalizimeve është mirë të përcaktohet se në cilat vende është intervenuar. Faqe 78 fjala bletarë është shënuar dy herë. Kërkoj sqarim për çështjen e të hyrave vetanake.

**Mallzum Qajani** thekson:- transporti në fshatin Pustenuk ka pasur por banorët tash janë shpërngulur. Furnizim me dru ka të bëjë për dru për djegëje për nxemje. Publikimi në TV Dielli vitin e kaluar ishte 20 vjetorin për dëshmorët e Hanit të Elezit dhe ka pas publikime për dëshmorët e trevës sonë . Sa i përket bravës së veturës komuna ka kontratë për mirëmbajtjen e veturave. Komuna ka bërë puse për furnizim me ujë por nuk ka pasur ujë sa duhet dhe në fshatin Dërmjak ka bërë shpime dhe është katër deri në pesë litra në sekondë dhe për momentin nuk përdoren puset. Sa i përket shpenzimeve në ambulante janë vetura të ndryshme dhe shpenzimet i kanë të ndryshme . Për çdo vit e paraqesim raportin për CA por nuk kemi kapacitete që do të ishim marr më detale se cilët janë shkaktarët e kancerit. Me kanalizimet kur është festa e Bajramit të Vogël probleme kemi më shumë sepse qytetarët mbeturinat e kurbanit i hedhin në kanalizim . Të hyrat vetanake janë vetëm për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

**Zaim Bela** thekson:- NTP Ahu është firmë e imja që në këtë vit ka bërë furnizimin me dru për administratën komunale, QKMF-në, SHML “Dardania”.

**Edon Curri** thekson:- sa i përket veturës Hiunday është ndërruar brava e vullanit kompletë dhe është përfshirë e transporti i veturës. Tabela gjenerohet prej sistemit për shkak se sistemi kur i pranon lëndët është kolona e parë që shënon pranuar dhe në momentin që dërgohet në drejtori del në proces lënda pastaj në momentin që miratohet ajo lëndë del te totali i lëndëve në fund

**Bajrush Laqi** thekson:- si komunë kemi lloje të ndryshme të padive por mund të themi që 95 % komuna i ka fituar. Për vitin 2019 nuk ka ndonjë rast për veç disa rasteve që komuna ka bërë marrëveshje jashtë gjygesore me palët të cilat kanë shkuar në favor të komunës.

**Naser Laqi** thekson:- për shpenzimet e autoambulancave e kemi bërë një komision i cili është duke i identifikuar edhe një herë jashtë raportit të cilin e kanë dërguar prej QKMF-së .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- përgjigje nuk më është dhënë nga zyra e transparencës për çështjen e fshirjes së komenteve.

**Bashkim Sopa** thekson:- sa i përket kësaj përgjigje nuk kam koment.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN E PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.**

### **3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- buxheti për vitin 2019 është në lartësi prej 2,915,921.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 3,205,548.08 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-dhjetor 2019 është në shumë prej 3,133,210.06 € apo 97.74 %. Sipas kategorive ekonomike për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,478,773.44 € apo 99.04 %, mallra dhe shërbime 261,826.75 € apo 99.88 %, shpenzime komunale 54,368.73 € apo 99.94 %, subvencione dhe transfere 66,103.40 € apo 99.79 % dhe shpenzime kapitale 1,272,137.74 € apo 95.68 %. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Shqyrtimi i propozim vendimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- rritje kemi në shumë prej 32,306.51 € me krahasuar me atë që është planifikuar dhe rritja është e planifikuar se ku do të transferohet. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR RITJEN E BUXHETIT NGA TË HYRAT VETANAKE PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**5. Shqyrtimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimi) e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- e dimë që një numër i projekteve që planifikohen në vitin kalendarik jemi të vetëdijshëm që nuk mund ta realizojmë për shkak të projekteve të ndryshme që mund të vijnë dhe kemi projekte që i dedikojmë të hyrat vetanake dhe nëse vijnë donacione ato të hyra vetanake na kthehen. Për vitin 2019 nuk janë shpenzuar 85,891.91 € dhe këto mjete duhet të riplanifikohen për vitin 2020. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR BARTJEN (RIALOKIMIN) E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI I KALUAR NË VITIN AKTUAL QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**6. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratim dhe realizimi të projektit kapital “Kanali i mbyllur për ujërat atmosferike “ Seqishtë.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- rregullimin e kanaleve atmosferike dhe fekale i kemi si projekte të përbashkëta dhe me që kemi fituar një projekt të përbashkët prej fondit IPA dhe mjetet duhet të dalin për projektin konkretë por duhet të bëjmë një kod të veçantë për këtë çështje . Këtë projekt e kemi përfituar si bashkëpunim ndër kufitarë me komunën e Gazibabës, kontrata është nënshkruar dhe besojmë që ka muaji qershor apo korrik do të fillojnë punimet. Materiali është dërguar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIM DHE REALIZIM TË PROJEKTIT KAPITALE ”KANALI I MBYLLUR PËR UJRAT ATMOSFERIKE” QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**7. Shqyrtimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- janë mbajtur dymbëdhjetë mbledhje të rregullta, një mbledhje solemne dhe një mbledhje komemorative. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**8. Informatë mbi raportin vjetor 2019 të NPL Pastrimi Sh.A.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabedin Hasallari** thekson:- sa persona nuk kanë bërë kontrata dhe mbeturinat i hedhin në vende të ndryshme.

**Kujtim Dernjani** thekson:- evidencë nuk kemi por nga vetë fakti që për çdo vit po bëhen kontrata të reja po shohim më pak mbeturina në teren dhe qind për qind nuk mundemi me i eliminuar por jemi duke u munduar me i ndaluar.

**Sabedin Hasallari** thekson:-kompania është duke i kryer shërbimet dhe çdo shërbim që bëhet nuk mund të kryhet pa mjete financiare por duhet të ketë shënime të sakta se sa ekonomi familjare nuk paguajnë sepse po e dëmtojnë ambientin dhe të tjerët që paguajnë me rregull.

**Kujtim Dernjani** thekson:-evidenca është bërë dhe në teren është shkuar shtëpi për shtëpi te ata persona që nuk kanë paguar. Ne duhet t'i kuptojmë edhe qytetarët në mënyrë që mos me shkuar direkt në masa përmbarimore.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATI MBI RAPORTIN VJETOR 2019 TË NPL PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Teuta Shkreta** thekson:- a ka pasur ndonjë takim me KEDS-in komuna për shkak se rryma është ndërprerë katër ditë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë vetëm po ua rikujtojë çështjen e trafos dhe kanalizimit në fshatin Pustenic që është mirë të rregullohet. Duhet dikush të merr iniciativë për këtë çështje.

**Mallzum Qajani** thekson:- puna e rrymës nuk është në kompetencë të komunës dhe me që është problem për qytetarët na duhet të merremi me këtë çështje, mirëpo çështja e rrymës është çështje e KEDS-it. Është biseduar kjo çështje dhe besoj që në këtë vit do të rregullohet çështja e trafo në fshatin Pustenic për shkak se KEDS-i ka potencuar se është në prioritet me u zgjidhur çështja e rrymës në fshatin Pustenic. Problemi i rrymës në Lagje të Re është sepse rrjeti shkon edhe në fshatin Krivenik por duhet ta dimë që ka qenë një mot i jashtëzakonshëm dhe problem kanë pasur të gjithë dhe qytetarët e lagjeve të ndryshme dhe banorët vullnetarisht kanë dalur dhe e kanë ndihmuar KEDS-in dhe duhet t'i falënderojmë. Çështja e kanalizimit është problem i pronave por është edhe problem se ku me dërguar kanalizimin për shkak se me lidhë me kanalizimin e Hanit të Elezit duhet investim i madh.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpall të mbyllur mbledhjen. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

Procesmbajtësi

Avni Bushi

